

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË FINANCIMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (MARRËSI), PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCIVE DHE EKONOMISË, DHE KfW FRANKFURT AM MAIN (KfW), PËR PROGRAMIN E REHABILITIMIT TË KONVIKTEVE TË UNIVERSITETIT TË TIRANËS SIPAS PARIMIT TË EFIÇENCËS SË ENERGJISË, FAZA II”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë (marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am main (KfW), që propozohet për ratifikim me anë të këtij projektligji synon financimin me një fond grant prej 2 032 179.23 (dy milionë e tridhjetë e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë njëzet e tre) eurosh të programit rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të efikasitetit të energjisë, faza II.

Lidhja e kësaj marrëveshjeje propozohet në vijim të marrëveshjes qeveritare të nënshkruar, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim financiar 2016, për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës sipas parimit të efikasitetit energjitike, faza II”, e cila është ratifikuar nga Kuvendi me anë të ligjit nr.94/2017. Me qëllim vënien në jetë të financimit të rënë dakord me anë të marrëveshjes qeveritare si dhe realizimin e programit përkatës, nevojitet lidhja e marrëveshjes financiare me KfW, si institucioni financiar i ngarkuar nga qeveria gjermane për akordimin dhe zbatimin e financimeve që sigurohen në kuadër të bashkëpunimit për zhvillim ndërmjet dy vendeve. Sigurimi i këtij financimi me grant në vlerën prej 2 032 179.23 (dy milionë e tridhjetë e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë njëzet e tre) eurosh synon zbatimin e masave të efikasitetit të energjisë në rehabilitimin e godinave të konvikteve të Universitetit të Tiranës, ku parashikohet rehabilitimi i pesë godinave.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është i përfshirë në programin analitik të akteve për vitin 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Ratifikimi i kësaj marrëveshjeje do të mundësojë sigurimin e një financimi që i akordohet Republikës së Shqipërisë në vlerën prej 2 032 179.23 (dy milionë e tridhjetë e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë njëzet e tre) eurosh nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW), për projektin “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin universitar të Tiranës sipas parimit të efijencës energjitike, faza II”.

Marrëveshja përkatëse qeveritare për këtë shumë financimi është nënshkruar dhe ratifikuar në vitin 2017. Ky financim me grant do t’i bashkohet një financimi tjetër të dakordësuar me qeverinë gjermane në vlerën prej 4 500 000 (katër milionë e pesëqind mijë) eurosh ku marrëveshja përkatëse qeveritare është lidhur dhe ratifikuar gjatë vitit 2016. Financimi shtesë që akordohet me anë të marrëveshjes bashkëlidhur këtij projektligji (e cila emërtohet si fazë e dytë vetëm për arsye të koncepteve të palës gjermane mbi alokimin e fondeve nga vite të ndryshme buxhetore) vjen si rezultat i bisedimeve qeveritare mbi bashkëpunimin për zhvillim të mbajtur po në vitin 2016, ndërmjet qeverisë shqiptare dhe asaj gjermane, ku qeveria gjermane propozoi të shtojë shumën e financimit për ta bërë investimin më të plotë. Aktualisht, po procedohet me marrëveshjet përkatëse të financimit që do të lidhen me KfW-në (marrëveshja që i bashkëlidhet këtij projektligji si dhe marrëveshja tjetër e financimit e cila gjithashtu po i nënshtrohet procedurave që parashikon kuadri ligjor në fuqi për bërjen efektive).

Rëndësia dhe objektivat e programit

Strategjia për zhvillimin e sektorit energjetik është pjesë e strategjisë së përgjithshme për zhvillimin ekonomik të Shqipërisë, ku pjesë e analizës janë dhe ndryshimet shumë të domosdoshme në lidhje me rritjen e sigurisë për furnizimin me energji dhe optimizimin e burimeve të energjisë, me qëllim përmbushjen e kërkesës dhe arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm në të ardhmen. Pjesë e kësaj strategjie është edhe efijenca e energjisë dhe burimet e rinovueshme. Ligji nr.116/2016, “Për performancën e energjisë në ndërtesa” vendosi përfundimisht kërkesat kryesore lidhur me efijencën e energjisë në ndërtesat që i nënshtrohen rinovimit. Ky lloj rinovimi që kërkohet në konviktet e Universitetit të Tiranës është në përputhje dhe do të plotësojë kushtet që përcakton ky legjislacion për rinovimin në ndërtesa publike, siç janë konviktet.

Qëllimi i programit është rehabilitimi i konvikteve të Universitetit të Tiranës, në funksion të rritjes e efijencës së energjisë dhe kushtet e komfortit të studentëve sipas kërkesave minimale të performancës së energjisë. Në varësi të buxhetit në dispozicion, projekti do të përfshijë rehabilitimin e konvikteve nr.3, 14, 16, 17 dhe 18. Përpara se të fillojnë punimet për rehabilitimin me kushtet e efijencës së energjisë, është e nevojshme të përcaktohet fillimisht performanca

energjetike aktuale e këtyre ndërtesave nëpërmjet kontrolleve të energjisë dhe auditimin energjetik të godinave, të dhëna të cilat do të detajohen më tej nga konsulenti me qëllim krahasimin e këtij indikatori të performancës energjetike ($\text{kwh/m}^2\text{vit}$) para dhe pas rehabilitimit të godinave.

Është rënë dakord, në parim, me administratën e konvikteve të Universitetit të Tiranës që do të realizohen tri kategori të ndryshme të apartamenteve studentore: Kategoria I - do të bazohet në 6-8 studentë që do të ndajnë një banjë dhe një aneks kuzhine; Kategoria II – do të bazohet në 4 studentë që do të ndajnë të njëjtën infrastrukturë; dhe Kategoria III - është bazuar në 2 studentë që do të ndajnë një banjë dhe një aneks kuzhinë. U ra dakord që shumica e apartamenteve të rinovuara do të jenë të kategorisë së tipit I, për të përballuar nivelin e varfërisë së shumicës së studentëve që aplikojnë për dhoma në konviktet e Universitetit të Tiranës. Së bashku me rehabilitimin energjetik të ndërtesave, masat themelore të komfortit, sipas kushteve të vendosura nga ligji nr.116/2016, do të jenë një pjesë e konsiderueshme e programit, si për shembull rinovimi i instalimeve sanitare, rinovimi i pajisjeve elektrike, sistemin e ngrohjes, ftohjes, ventilimit, prodhimit të ujit të ngrohtë sanitar, masat e sigurisë, lavanderi me operim monedhash, dhoma të përbashkëta studimi etj., në mënyrë që të përmirësohet jetesat dhe mjedisi i të mësuarit për studentët.

Qëllimi i përgjithshëm i “Programi për rinovimin e konvikteve në kampusin Universitar të Tiranës sipas parimit të efikasitetit të energjisë, faza II” ka për qëllim aplikimin e masave të efikasitetit të energjisë në godinat e konvikteve të Universitetit të Tiranës me objektivat, si më poshtë:

- Auditimin energjetik të ndërtesave për të identifikuar konsumin e energjisë dhe masat përkatëse që duhen për të reduktuar konsumin e energjisë. Raporti i auditimit do të certifikojë ndërtesën para dhe pas rinovimit.
- Identifikimi i nevojave të rinovimit të ndërtesave në lidhje me gjendjen aktuale të tyre me qëllim për të zgatur ciklin e jetës së ndërtesave.
- Identifikimi i masave të ndryshme të efikasitetit të energjisë që mund të aplikohet, si dhe llogaritja e kursimit të energjisë në secilën prej godinave, me qëllim përcaktimin e kriterëve dhe masave të efikasitetit të energjisë me një kosto të lartë përfitimi. Kjo nënkupton vendosjen e një kostoje optimale për rinovimin e ndërtesës, në përputhje me kërkesat minimale të përcaktuara në ligjin nr.6/2016.
- Reduktimi i konsumit të përgjithshëm të energjisë së ndërtesave duke synuar që treguesi i performancës së energjisë të jetë të paktën 75 kwh/m^2 në vit dhe të sigurojë përmirësimin e kushteve të jetesës së studentëve.
- Llogaritjen e reduktimit të karbonit si rezultat i masave dhe vendosjes në kushte të performancës së lartë (sipas synimit të mësipërm $75 \text{ kwh/m}^2\text{vit}$) dhe standardeve të Bashkimit Evropian.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë është ministria përgjegjëse për zbatimin e projektit, e cila do të bashkëpunojë ngushtë me Bashkinë e Tiranës, si institucioni që ka në përgjegjësi administrimi konviktet, si dhe me administratën e shoqërisë studentore Universitare të Tiranës / Qyteti Studenti nr.1, si përfituese e këtij projekti.

Projekti parashikohet të fillojë në vitin 2018 dhe do të zgjasë nga 18 deri në 24 muaj.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji i propozuar është në përputhje me nenet 81, pika 1, dhe 100, të Kushtetutës, dhe në nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Marrëveshja u miratua, në parim, nga Këshilli i Ministrave, me anë të vendimit nr.750, datë 13.12.2017, u nënshkrua ndërmjet palëve dhe po i nënshtrohet procedurës që parashikon kuadri ligjor në fuqi për bërjen efektive të marrëveshjeve ndërkombëtare.

Projektligji është në përputhje me ligjin nr.116/2016, “Për performancën e energjisë në ndërtesa”, dhe ligjin nr.124/2015, “Për efikasitetin e energjisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS COMMUNAUTAIRE (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Ky projektligj nuk përfron me ndonjë akt ligjor të BE-së.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji parashikon propozimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW), për financimin e programit të rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të efikasitetit të energjisë, faza II” nëpërmjet një granti në shumën prej 2 032 179.23 (dy milionë e tridhjetë e dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë pikë njëzet e tre) eurosh.

Teksti i marrëveshjes i bashkëngjitet projektaktit.

VII.INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e projektligjit ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Projekti do të zbatohet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë dhe administratën e shoqërisë studentore universitare të Tiranës.

VIII.RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Kostoja e projektit të rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të efikasitetit të energjisë vlerësohet në shumën prej 7.8 milionë eurosh, e cila do të financohet nga:

- a) KfW-ja me anë të granteve në shumën totale prej rreth 6.5 milionë eurosh (rreth 2 milionë euro nëpërmjet marrëveshjes aktuale të financimit dhe 4.5 milionë euro me anë të një marrëveshjeje tjetër financimi);
- b) buxheti i shtetit i cili do të mbulojë TVSH-në dhe kostot lokale të projektit, kosto këto të parashikuara në shumën totale prej 1.3 milionë eurosh.

KËSHILLI I MINISTRAVE